



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës Bexhet Kuçi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Suharekës
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL
Nga:	Erbilin Hetemi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor, MAPL
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim të aktit
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës së Suharekës

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e komunës si në vijim:

Vendimi 01-Nr-020-24518 për themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale
I miratuar më datë: 29.05.2026
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 29.05.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës, nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Suharekës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.05.2026, ka miratuar Vendimin 01-Nr-020-24518 për themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale.

MAPL, konstaton se vendimi i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Suharekës, është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, sepse nuk është respektuar përfaqësimi gjinor siç parashihet me :

Nenin 6, paragrafët 7 dhe 8 të Ligjit Nr. 05/L-020 për barazi gjinore, ku përcaktohet se: *"Organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore në të gjitha nivelet, si dhe institucionet tjera publike, janë të obliguara të miratojnë dhe zbatojnë masa të veçanta për të arritur përfaqësimin e gjinisë në pak të përfaqësuar, deri në arritjen e përfaqësimit të barabartë të femrave dhe meshkujve sipas këtij ligji.*

Po ashtu, neni 5, paragrafi 3, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, përcaktohet se:

"Komisioni do të reflektoj përfaqësimin gjinor dhe etnik".

Andaj bazuar në të lartcekurat, kuvendi i komunës së Suharekës, duhet të ndërmerr veprime dhe brenda afatit ligjor prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin me legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.